

Revista Alumni Nr 1, 2014

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE



RRJETI ALUMNI

Një hapësirë e pasur
vlerash dhe idesh

ASP



Përse një revistë?

Të dashur lexues,

Sot merr rrugë numri i parë i revistës vjetore të alumnëve (ish-pjesëmarrësve) të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike. Është një botim që u drejtohet vetë alumnëve, por njëkohësisht synon t'iu shërbejë atyre si një mundësi e mëtejshme promovimi të arritjeve në karrierën e tyre personale, si edhe aktiviteteve të përbashkëta të organizuara nga ky rrjet.

Që prej vitit 2007, programi i shkollës së studimeve politike ka shërbyer si një mundësi e mirë edukimi dhe organizimi e profesionistëve dhe të zgjedhurve politikë me bindje të ndryshme. Tashmë, këta drejtues të rinj, kanë hedhur hapa të mëtejshëm suksesi dhe shumë prej tyre mbajnë edhe poste të rëndësishme vendim-marrëse apo politikëbërëse dhe kanë eksperiencën e nevojshme kërkuese dhe këshilluese. Është e nevojshme pra, që të gjenden rrugët e duhura të organizimit kombëtar dhe rajonal të alumnëve të shkollës shqiptare në bashkëpunim me alumnit e shkollave të tjera politike të Këshillit të Evropës, në mënyrë që të nxitet

krijimi i shoqërive demokratike dhe aktive, të kapërcehen pengesat e krijuara nga perceptimet e vjetra historike, drejt integritimit sa më të shpejtë evropian të vendit dhe rajonit tonë. Revista është një hap i mëtejshëm i hedhur drejt gjetjes së këtyre mënyrave të organizimit dhe bashkëpunimit të alumnëve.

Ky botim i ri do të jetë gjithashtu i hapur për artikujt, ekspertizat dhe kërkimet shkencore të çdo alumni apo grupi alumnish, me shpresën se do të shërbejë si promovues i mëtejshëm i punimeve sugjeruese për institucionet qendrore apo ato ndërkombëtare. Këto ekspertiza mund të gjejnë më pas pasqyrim dhe mundësi të mëtejshme mbështetjeje financiare dhe shkencore falë rrjetit të gjerë të bashkëpunëtorëve vendas dhe të huaj të Akademisë së Studimeve Politike.

Mbetet tashmë që vetë pjesëtarët e këtij rrjeti të madh dhe ekskluziv drejtuesish të rinj, të aktivizohen dhe shfrytëzojnë sa më mirë faqet e kësaj reviste. Është një udhëtim i sapo nisur me synimin për të qenë sa më i gjatë.

www.asp.al faqja e re online

Një platformë e re interaktive komunikimi e Akademisë së Studimeve Politike i shtohet së fundi kanaleve të shumta të komunikimit dhe promovimit të pjesëmarrësve dhe alumnëve të shkollës. Portali www.asp.al është ideuar që të përmbajë një përshkrim të detajuar të profilin të Akademisë si organizata që zbaton programin e Shkollës së Studimeve Politike, por njëkohësisht përmbledh në një faqe të vetme të gjitha programet e tjera që zbatohen nga Akademia. Falë dizajnit bashkëkohor kjo faqe është më e arritshme nga të gjitha përdoruesit dhe njëherazi mund

të shërbejë si një vlerë e shtuar e vizibilitetit të programeve që zbatohen në fusha të ndryshme të edukimit dhe aktivizimit civil. Një fokus i vecantë i është lënë në këtë faqe të re edhe prezantimit të listës së detajuar të alumnëve të shkollës si dhe lidhjeve me shkollat e tjera të Këshillit të Evropës. Nëpërmjet fjalës së fundit të teknologjisë, mund të aksesohen në çdo moment dhe nga çdo pajisje elektronike publikimet e ndryshme të Akademisë ndër vite. Kjo do të bëjë të mundur shpërndarjen në një fashë më të gjerë të materialeve kërkimore dhe sugjeruese të përgatitura nga

pjesëmarrësit dhe ekspertët e angazhuar në projektet e ndryshme. Faqja e re e web-it është një mundësi e mëtejshme lidhjeje me rrjetet sociale Facebook, dhe LinkedIn, ku promovohen të rejtat dhe aktivitetet e prishme të programit të shkollës. Prej disa muajsh, këto rrjete sociale janë shfrytëzuar si mundësi për të promovuar ecurinë e karrierës së alumnëve që kanë marrë detyra të reja pas zgjedhjeve të 23 Qershorit 2013. Sigurisht të gjithë ndjehemi krenarë për hapat e rëndësishëm të hedhur prej këtyre antarëve të rrjetit tonë të madh.



Na duhen modele pozitive



Erjon Tase

Drejtor ekzekutiv
i Akademisë së Studimeve Politike
Alumni i vitit akademik 2008

Këto ditë do të diplomojmë brezin e shtatë të liderëve të ardhshëm politikë dhe aktivistëve civilë, të cilët pas këtij momenti do t'i bashkëngjiten rrjetit të mbi 200 alumnëve, që kanë përfunduar programin e shkollës. Nuk mund të mos ndjehemi krenarë për këtë familje të madhe drejtuesish, që pas përfundimit të kurseve të trajnimit dhe certifikimit, kanë vazhduar karrierën personale dhe tashmë mbajnë pozicione të rëndësishme politike dhe shoqërore. Deri më sot ata kanë vepruar si përcjellës të vlerave demokratike të pluralizmit, diversitetit dhe dialogut të hapur në fushat e tyre respektive të karrierës. Pas këtyre shtatë viteve të funksionimit të shkollës, besojmë se ka ardhur momenti i duhur që ky rrjet ekspertësh të arsimuar dhe mbrujtur me vlerat më të mira evropiane, të fuqizojë dhe promovojë më tej rolin e tij në shoqërinë shqiptare. Pikërisht në këtë periudhë krizash ekonomike dhe morale, kur ëndrra evropiane e ka humbur vezullimin e saj, ndihma e një brezi drejtuesish të rinj, të edukuar dhe profesionistë është më e vlefshme se kurrë. Shqipëria ka nevojë për drejtues që duan të mësojnë më shumë, të shkëmbejnë idetë e tyre me të tjerë të ngjashëm, e aq më tepër të ndryshëm, ashtu siç kanë bërë të gjitha pjesëmarrësit e programit të shkollës sonë. Në këtë mënyrë këta pjesëmarrës, sot alumni, kanë mundur të përmirësojnë vetveten dhe mënyrën e drejtimit duke qenë më të hapur për t'iu përgjigjur kërkesave të zgjedhësve apo edhe bashkëpunëtorëve të tyre në administratë apo biznes privat; më të hapur për të dëgjuar këshillat e duhura përpara vendimmarrjes, më tolerantë për më të dobët, më reagues ndaj kritikave dhe sugjerimeve. Me pak fjalë, udhëheqës

më të mirë, që kapërcejnë interesat e tyre personale apo të partisë, në emër të zhvillimit dhe integritetit të vendit. Pikërisht në këto kohëra të vështira për demokracinë, kur politika duket më e larguar se kurrë nga qytetarët për shkak të blerjes së votës, drejtësia e kontrolluar dhe shoqëria civile e shitur, është momenti i përshtatshëm për të promovuar më tej shembuj e mirë të drejtuesve të rinj, të cilët gjenden në rrjetin tonë të alumnëve. Sigurisht që dyqind persona janë ende pak për të përmbytur shembujt e shumtë të pasurimit të shpejtë dhe të pamerituar të politikanëve apo drejtorëve të korrupsionit të administratës. Modele, të cilat iu afrohen prej më shumë se dy dekadash të rinjve shqiptarë si përfitime dhe nxitje të pjesëmarrjes në politikë apo angazhimin civil.

Ndoshta do të duhet ende kohë dhe përpjekje për të ndryshuar këtë raport negativ forcash, por kjo situatë nuk mund të vazhdojë pafundësisht sepse edhe qytetarët shqiptarë nuk janë më ata të 23 viteve më parë. Tashmë, përtej ngjyrave partiake, ata presin që të drejtohen nga udhëheqës të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, institucione të pavarura që garantojnë ligjin dhe sigurinë e jetës, më pak korrupsion dhe pasiguri, më shumë ndërgjegjësim për mjedisin dhe një shoqëri më sociale për më të varfrit dhe të diskriminuarit. Për të shpejtuar rrotën e kohës drejt ndryshimit të kësaj situatë 23-vjeçare, duhet të "shkunden" të gjithë. Pikërisht, forcimit të ndërgjegjësimit se çdokush duhet të ndryshojë të përditshmen e tij të vogël për të arritur ndryshimin e madh të pritshëm, i shërbejnë edhe modelet pozitive të rrjetit të alumnëve të shkollës së studimeve politike, që po ju sjellim në këtë revistë.



Shtatë gjenerata të alumnëve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” u mbledhën në takim të parë të alumnëve, të organizuar më 19 dhjetor 2013, në mjediset e hotel “Tirana International”. Më shumë se njëqind ish-pjesëmarrës të këtij programi të viteve 2007 - 2013, shkëmbyen mendime mbi forcimin e këtij rrjeti alumnësh, si pjesë e një iniciative më të gjerë të ndërmarrë nga Këshilli i Evropës në të 19 shkollat politike që funksionojnë në Evropën Lindore, Juglindore dhe tashmë edhe në Afrikën Veriore.

Disa nga pikat kryesore të diskutuara ishin nevoja për të rifreskuar informacionin dhe karrierën e alumnëve; prezantimi i revistës vjetore të alumnëve si dhe prezantimi i dy programeve të reja rajonale të shkollave politike si “Akademia Rajonale për Demokraci” dhe seminari vjetor i alumnëve të shkollave politike.

Alumnit ekspertizë për KiE

Të pranishëm në këtë event ishin shefi i zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Marco Leidekker si dhe znj. Anne Savary, zv.drejtoresh e Agjencisë Zvicerane të Bashkëpunimit në Shqipëri, organizatë falë së cilës financohet aktualisht programi i shkollës. Në fjalën e tij, z. Leidekker garantoj të pranishmit për rëndësinë



TAKIMI I PARË I ALUMNËVE 2007-2013.

KËSHILLI I EVROPËS KËRKON EKSPERTIZËN E PJESËTARËVE

Një rrjet i madh idesh dhe eksperiencash





Seti i fotove nga takimi me alumnit e viteve 2007-2013. Në faqen tjetër, drejtori i ASP, Erjon Tase dhe shefi i zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Marco Leidekker. Majtas, stema e përgatitur për këtë takim

Alumnit në Akademinë Rajonale për Demokracinë



Akademia Rajonale për Demokracinë është një nga eventet më të rëndësishme rajonale, e cila mbledh së bashku çdo vit 50 udhëheqës të rinj nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Nëpërmjet seminareve dhe vizitave të përbashkëta studimore, synohet që të rriten njohuritë dhe mirëkuptimi në nivel rajonal, por edhe të krijohen lidhjet e nevojshme për zhvillimin dhe integrimin e Ballkanit.

Në programin e vitit të parë (viti akademik 2013) morrën pjesë dhe u certifikuan katër alumni të shkollës sonë, përkatësisht Edlira Gjoni, Arbër Kadia, Sokol Bega dhe Qamil Dika. Ndërkohë, koordinimi i grupit shqiptar në këtë program, iu besua alumnit Rezart Xhelo. Përgjatë vitit të dytë të Akademisë Rajonale, janë selektuar mbi bazën e profilin e tyre dhe përputhjes me tematikën e sivjetshme, alumnit Edlira Nasi, Ledio Braho dhe Rezart Xhelo.

Programi financohet nga Bashkimi Evropian si dhe Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit dhe fondi "Balkan Trust for Democracy". Rrjeti i shtatë shkollave politike të Këshillit të Evropës në rajonin e Ballkanit siguron zbatimin e projektit në nivel vendor dhe koordinon bashkëpunimin rajonal. Ky program do të vazhdojë deri në vitin 2015 të kontribuojë për ndërtimin e një gjenerate të re udhëheqësish, të cilët do të kapërcejnë barrierat historike që ekzistojnë në Ballkan.



që i kushton Këshilli i Evropës rrjetit të shkollave politike si dhe mbështetjen e mëtejshme për nxitjen e angazhimit të alumneve. Një nga fushat kryesore të këtij angazhimi, mund të jetë edhe ofrimi i ekspertizës profesionale për Këshillin e Evropës dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë, në fusha të ndryshme ku alumnit vazhdojnë karrierën e tyre. Alumnët e shkollës mund të jenë pjesë e takimeve faktmbledhëse të misioneve

raportuese të Këshillit të Evropës, apo edhe të sugjerojnë qëndrimet e tyre profesionale për çështje aktuale, si për shembull, reforma territoriale, reforma gjyqësore apo legjislacioni i medias. Për këtë qëllim, Akademia e Studimeve Politike, ka nisur edhe rifreskimin e databazës së të dhënave dhe fushës së ekspertizës të antarëve të rrjetit të alumneve.



Angazhimi i alumneve

Z. Erjon Tase, drejtori ekzekutiv i "Akademisë së Studimeve Politike", organizon që zbaton programin e shkollës politike, nënvizoi në fjalën e tij rëndësinë e rrjetit të alumneve si përqjes të

...Alumnët e shkollës mund të jenë pjesë e takimeve fakt-mbledhëse të misionëve raportuese të Këshillit të Evropës...

vlerave më të mira në zhvillimin e një shoqërie demokratike shqiptare. "Deri më sot, alumnët kanë dhënë kontributin e tyre si bashkëpunëtorë në zbatimin e programeve të Akademisë, si programi i edukimit të votuesve për herë të parë apo edhe programi për legjislacionin e efikasitetit të energjisë", u shpreh z.Tase. Ndërkohë, kontributi i alumneve në të ardhmen mund të shfrytëzohet edhe në fushën e kërkimeve shkencore apo inisiativa të ndryshme publike në fushën e mirëqeverisjes dhe pjesëmarrjes qytetare. Ai ftoi edhe njëherë alumnit që të marrin nisma të mëtejshme organizimi dhe bashkëpunimi në funksion të nxitjes së një shoqërie aktive dhe pjesëmarrëse.

Programet rajonale

Dy projektet e reja rajonale, që u prezantuan në këtë takim, do të shërbejnë më

tej për të siguruar bashkëpunimin mes alumneve të shkollave të ndryshme politike të Këshillit të Evropës. Programi "Akademia Rajonale e Demokracisë", ka përfshirë 8 alumnë në dy vitet e para të tij, të cilët kanë mundësinë të diskutojnë dhe krijojnë ura bashkëpunimi me liderë të tjera vendas dhe nga i gjithë rajoni i Ballkanit.

Ndërkaq, inisiativa e Këshillit të Evropës për të organizuar çdo vit në Strasburg një seminar me alumnët e të gjitha shkollave politike, është një tjetër risi pozitive për forcimin e rrjetit alumni edhe më gjerë se Ballkani.

Me mjaft interes u ndoq prej të pran-



Nga takimi i alumneve të shkollës me delegacionin e Parlamentit Evropian për Evropën Juglindore mbi perspektivën europiane të Shqipërisë

ishmëve edhe prezantimi i idesë për botimin e revistës së alumneve, një pasqyrë e sukseseve dhe promovimit të pjesëmarrësve të rrjetit, por edhe kontributit personal të tyre. Vazhdimi i aktiviteteve në formën e një koktejl shërbeu si një mundësi e mirë për alumnit e shtatë gjeneratave të ndryshme për t'u njohur më mirë dhe shkëmbyer kontaktet e tyre.





Seminari i alumnëve të shkollave politike Strasburg 2014

Drejtorja e Planifikimit të Politikave pranë Këshillit të Evropës, organizmi që koordinon shkollat e studimeve politike, do të organizojë në muajin Qershor 2014 një seminar dy ditor me 40 alumni të këtij rrjeti ndërkombëtar. Takimi do të zhvillohet pranë selisë qendrore të Këshillit të Evropës në Strasburg dhe ka për qëllim që të mbledhë së bashku alumni që janë të zgjedhur apo mbajnë poste të larta në vendet e tyre. Çdo shkollë do të hapë thirrjet për aplikim dhe sugjerojë dy kandidatë për të qënë të pranishëm në këtë event ndërkombëtar në javët në vazhdim. Tematika e seminarit nuk është përcaktuar ende, por thelbi i takimit do të jetë nisja e një procesi që krijon kushtet e nevojshme për krijimin e lidhjeve

Mbledhja e drejtorëve, diskutime për platformat e alumnëve

Në datat 3-4 Prill 2014 pritet të zhvillohet takimi vjetor i drejtorëve të 19 shkollave politike të Këshillit të Evropës. Mbledhja do të organizohet në ambjentet e Komisionit të Venecias, strukturës së njohur që ofron ekspertizën e saj për reformat e ndryshme ligjore edhe në vendin tonë. Qëllimi i këtij takimi do të jetë diskutimi dhe koordinimi i drejtorëve të shkollave për mbarëvajtjen e programit të shkollave në vendet e tyre respektive, por njëherazi edhe fuqizimi i rolit të pjesëmarrësve të shkollave në Forumin Botëror të Demokracisë, që do të zhvillohet edhe këtë vit në periudhën e vjeshtës, në selinë e Këshillit të Evropës në Strasburg.

Në fokus të këtij eventi do të jetë edhe gjetja e rrugëve të mëtejshme të angazhimit të alumnëve të shkollave politike, një rrjeti që numëron mijëra pjesëmarrës në vendet ku zhvillohet programi. Këshilli i Evropës po shikon



Mbledhja e fundit e drejtorëve, nëntor 2013

mundësinë e financimit të aktiviteteve të vazhdueshme rajonale dhe më gjerë të alumnëve të shkollave. Gjithashtu është duke u diskutuar ideja e krijimit të kurseve online, në mënyrë që alumnit të vazhdojnë të ndjekin prezantimet e lektorëve apo edhe të japin kontributin e tyre nëpërmjet blogjeve apo platformave të tjera online duke shkurtuar largësinë dhe koston e nevojshme për konferencat. Diskutimet dhe idetë e ndryshme mbi këtë angazhim, do të vazhdojnë edhe në muajt e ardhshëm ndërmjet drejtorëve dhe Këshillit të Evropës, me qëllim sigurimin e një terreni të duhur për rritjen e rolit të alumnëve.



Sekretari i Përgjithshëm i KfE, z. Thorbjorn Jagland me drejtorët e shkollave dhe pjesëmarrësit e Forumit Botëror për Demokraci 2013

dhe organizimin e një komunikimi afatgjatë të alumnëve të vendeve të ndryshme.

Këtij qëllimi do t'i shërbejë edhe seminari që është parashikuar të organizohet përgjatë këtij viti nga shkolla politike e Moskës, e cila është edhe shkolla e parë e Këshillit të Evropës, e krijuar në vitin 1992.

Seminari i alumnëve të Strasburgut mendohet që të kthehet në një aktivitet të përvitshëm të organizuar nga Këshilli i Evropës.

Çfarë ka qënë për ju Shkolla e Studimeve Politike ?

Në përfundim të programit të shkollës, shumë prej pjesëmarrësve kanë vazhduar të ngjisin shkallët e karrierës së tyre personale. Disa kanë provuar të angazhohen edhe politikisht duke marrë pjesë si kandidatë në zgjedhjet e fundit parlamentare. Ka patur të tjerë, të cilët falë eksperiencës së gjatë profesionale, janë ngjitur së fundi në poste të larta të administratës

qendrore dhe asaj vendore.

Sigurisht, merita kryesore për këto angazhime të reja dhe suksese, i atribuohet vetë vullnetit dhe mundit të derdhur nga gjithsecili prej këtyre alumnëve. Nëse edhe sadopak mund të kenë kontribuar në këtë qëllim të rëndësishëm njohuri të lektorëve të shkollës dhe eksperiencia e rrjetit tonë, jemi krenarë

për misionin tonë.

Me këtë synim, iu kemi drejtuar të njëjtën pyetje, disa prej alumnëve që përfaqësojnë fushat kryesore nga përzgjidhen pjesëmarrësit e shkollës:

Çfarë ka qënë Shkolla e Studimeve Politike për ju ?

Ata na kanë dhënë përgjigjet e mëposhtme:



Alumni
2008

Klodian Rjepaj

Zv/ Ministër i Shëndetësisë

“Kjo shkollë si mundësi e përballjes mes politikanëve dhe aspirantëve për t’u bërë pjesë e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, na dha mundësinë për të kuptuar se bindjet politike dhe qëndrueshmëria në parimet duhet të konvergojnë në interesin më të mirë publik për komunitetet në të cilat jetojmë, duke përmirësuar vetveten dhe ambjentin politik përreth.”

Eralda (Methasani) Çani

Këshilltare e Kryeministrit,
Lektore e së Drejtës Administrative

Alumni
2008

“Kjo shkollë është një vend ku inkurajohet zhvillimi i një komuniteti politikëbërësish të rinj dhe liderash agentë të demokracisë, të përkushtuar për zbatimin e modelit demokratik bashkëkohor të qeverisjes”





Alumni
2013

Evis Rrahmani

Përfaqësuese e Forumit të Gruas Socialiste, Drejtore e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë

“Jam e impresionuar nga koha që kalova në këtë shkollë. Një periudhë që do të mbetet ndër më të bukurat dhe të vlefshmet, e kaluar mes miqsh të mirë, profesionistësh e aktivistësh të denjë në pozicionet e tyre”



Alumni
2009

Mimoza Koçiu

Redaktore ABC News TV

Ish- këshilltare për mediat e Presidentit
“Shkolla arriti të ngjizte tek unë mënyrën e barazlorguar të qasjes ndaj politikës e demokracisë në Shqipëri. Shkëmbimi i eksperiencave me bashkënxënës të profesioneve të ndryshme, na inkurajuan në ngritjen e një rrjeti komunikimi, që edhe pse nuk është perfekt, e dimë që është aty, i hapur për secilin nga ne”

Besjan Pesha

Drejtues i partisë LSI,
Sekretar i përgjithshëm, Prefektura Tiranë

“Fundjavat me shkollën kanë qënë ndër më produktivet. Brenda pak ditësh kam mundur të njoh dhjetra të ngjashëm si unë në profesione të ndryshme, me shumicën jemi miq sot e kësaj dite dhe tek- tuk ngjizim dhe ndonjë bashkëpunim”

Alumni
2010



Ervin Karamuço,

Sekretar për zgjedhjet
Partia Fryma e Re Demokratike

“Pjesëmarrja ime ka qënë një eksperiencë mjaft e vlefshme. Kjo shkollë po kontribon çdo vit që në politikën shqiptare e reja ta mundë të vjetrën....dhe për këtë duhet të mbështetemi fort tek njëri-tjetri dhe parimet e demokracisë”

Alumni
2008





Alumni

2012

Suela Lala

Aktiviste për të drejtat e njeriut

“Një eksperiencë e veçantë lektrimi nga personalitete të politikës dhe profesionistë të spikatur si dhe diplomatë të huaj. Më ka shërbyer jo vetëm për të pasuruar njohuritë dhe sfiduar pikëpamjet, por edhe për të patur një rrjet më të pasur miqsh dhe bashkëpunëtorësh.”



Alumni

2008

Edlira Gjoni

Kandidate për deputete,
Partia Fryma e Re Demokratike
Gazetare

“Pjesëmarrja aktive në kurse dhe përfshirja në rrjetin alumni, më kanë ndihmuar në perceptimin e çështjeve politike, duke nxitur më tej investimin tim në politikë. Në jetën e përditshme, kam takuar shumë prej miqve të shkollës, me të cilët kemi bashkëpunuar përtej bindjeve politike”

Arian Galdini

Kryetar i Partisë për Liri,
Demokraci dhe Etikë

“Organizatorët, pjesëmarrësit, të ftuarit dhe lektorët e kësaj shkolle, kanë krijuar një ishull të mbarë shprese për këdo që e sheh dhe e do politikën si artin e shërbesës për të mirën e përbashkët. Ndihej i privilegjuar që kam patur mundësinë të kaloj edhe unë kohën time në këtë ishull të qëllim-mbarësisë”

Alumni

2012



Edvin Shvarc

Drejtor i Marrëdhënieve me
Jashtë dhe Koordinimit,
Presidenca e Republikës

“Shqipëria si gjithë Evropa” - Ky mendoj se ka qenë filli që na ka bashkuar në këtë Shkollë, ku të gjithë do të marrin një diplomë, e cila shpresoj nuk do të varet në ndonjë mur zyre si trofe, por do të përdoret përsëmbëri nga të gjithë në të mirën e përbashkët të ndërtimit të një kulture të re demokratike”

Alumni

2009

Qemal Çejku

Alumni
2010

Drejtor i Drejtorisë Arsimore,
Ish- zv. Kryetar Bashkisë Kamëz

“Shkolla Politike ka qenë fillimi i një realiteti të ri për mua. Falë saj, u nxitë të ndjek një seri kursesh e shkollash të ndryshme me fokus politikën, lobingun dhe ndërveprimin rajonal. Leksionet politike e profesionale, më ndihmuan për të hedhur hapin e duhur e të sigurtë në aktivitetin tim të përditshëm”



Altin Hoti

Zv.Rektor
Universiteti Luarasi

“Pyetjes se çfarë është shkolla për dikë, që kalon përmes saj, në jetën e “mëpastajme politike”, do t'i përgjigjesha shkurt: Miq që vlejnë, dije që shërbejnë. Shtyllat kryesore ku mbështetet suksesi, janë cilësia e pjesëmarrësve, njohuritë e lektorëve, duke kombinuar praktikën me teorinë, të huajën me vendasen”



Alumni
2012



Alumni
2007

Artur Hasanbelliu

Deputet i legjislatures 2005-2009,
Drejtor i gazetës “Republika”

“Si një deputet i ri, kjo shkollë më ka shërbyer si një mundësi unike për të kapërcyer ndasitë politike dhe për t'u ulur bashkë me përfaqësues të forcave të kundërta politike”



Alumni
2009

Plejada Gugashi

Drejtoreshë ekzekutive, organizata OLOF Palms Albania


“Një mundësi mjaft e mirë për të qenë pjesë e diskurseve më të fundit mbi politikën dhe zhvillimet në vend. Dhe mbi të gjitha, një mundësi e shkëlqyer për të njohur kolegë dhe miq me të cilët shpeshherë do të lidhë dhe puna”

Andi Seferi

Kandidat për deputet,
Partia Fryma e Re Demokratike

“Analizimi shumë dimensional i fenomeneve socio-politike në Shqipëri në raport me realitetin ndërkombëtar, më ndihmoi në krijimin e perceptimeve ndryshe nga ato të deritanishmet, duke më pajisur me një vizion bashkohor, të principshëm dhe mbi të gjitha në të mirë të kombit ”

Alumni
2012



Alumni
2008

Gjok Vuksani

Deputet i legjislatures 2005-2009,
Lektor pranë Universitet Bujqësor

“Njohuritë mbi institucionet evropiane, kanë qenë të vlefshme në karrierën time si deputet, por edhe në detyrën pasardhëse, në Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për hartimin e politikave bujqësore të integritit të bujqësisë shqiptare në BE”

Alban Tartari

Drejtor i PR “Albtelecom & Eagle Mobile”,
Gazetar

Alumni
2007

“Një eksperiencë e vyer për të njohur më mirë shkencën politike, një mundësi e mirë për profesionistë të fushave të ndryshme për t’u mbledhur sëbashku. Mendoj se kemi nevojë për modele të tilla që i shtynjë të rinjtë drejt studimit të politikës dhe jo militantizmit”



Për më tepër mbi rrjetin e alumnëve të shkollave politike të Këshillit të Evropës, mund të ndiqni linkun e mëposhtëm

<http://www.schoolsofpoliticalstudies.eu/alumni-corner.aspx>

VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratiane
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Specialist pranë stafit të Kryeministrit
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues
Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "World Vision"
Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet
Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës holandeze në Tiranë
Znj. Elma Tershana (Shehu)	Drejtoresh e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të Fëmijëve (UNICEF)
Z. Elton Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës
Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP
Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtoria e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjatë të e Lartë

Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM
Z. Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z. Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj. Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD
Znj. Sidita Gipali	Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë
Z. Teki Kurti	Kryetari i Këshillit të Komunës Martanesh

VITI 2008

Znj. Arbana Dibra	Drejtoresh ekzekutive e zyrës së OSBE-së në Shkodër
Z. Arben Vata	Kryeredaktor, "Ora News" TV
Znj. Beslinda Rrugja	Asistent avokate
Z. Bledar Kurti	Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Znj. Brasena Koka	Koordinatorë projekti pranë organizatës "World Vision"
Znj. Brunilda Minarolli (Peci)	Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme
Znj. Edlira Gjoni	Koordinatorë projektit EU-CARDS VET twinning / Gazetare
Znj. Edlira Mali	Drejtor Ekzekutiv e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë
Znj. Edlira Papavangjeli	Koordinatorë Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit
Znj. Elda Zotaj	Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës
Z. Elson Thana	Oficer i Policisë Gjyqësore
Znj. Elvana Zhezha	Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Znj. Eralda Cani Methasani	Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Z. Erion Avllazagaj	Lektor në Universitetin e Elbasanit
Z. Erjon Tase	Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"
Z. Erlis Cela	Gazetar në gazetën "Standard"
Z. ERVIN KARAMUCO	Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"
Znj. EVIS FICO	Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit

Z. FLIR MOSHO	Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave
Znj. GENTIANA RAMADANI	Drejtoresh ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"
Z. GJERGJI TANE	Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë
Z. GJOK VUKSANI	Deputet
Znj. IVIS NOCKA	Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes
Z. KLODIAN RJEPAJ	Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik
Znj. KLODIANA GJINAJ	Këshilltare për mediat pranë KESH
Z. MARIN MEMA	Gazetar "Top Channel"
Znj. MONIKA STAFI	Gazetare "Top Channel"
Znj. NAHLEL BEJLERI - FICO	Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror
Z. OLSI KARAPICI	Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave
Z. REMZI ALIAJ	Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror
Z. REZART LAHI	Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"
Znj. SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI	Menaxhere dege e "Opportunity Albania"
Znj. VILMA PREMTI	Drejtoresh në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z. Adrian SHEGA	Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë
Znj. Admira Poci	Specialiste pranë Institutit Goethe
Znj. Albana HANA	Specialiste në Ministrinë e Integritimit
Znj. Ana XHEKA	Drejtoresh në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Znj. Ardita SHEHAJ	Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës
Znj. Beti NJUMA	Gazetare, "Top Channel"
Z. Blerim KOLA	Kryeredaktor, Nesër TV
Z. Edvin SHVARC	Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokollit pranë Presidentit të Republikës
Znj. Elira CANGA	Gazetare, "Gazeta Shqiptare"

RRJETI ALUMNI 2007-2013

Znj. Elsa TOSKA (DOBJANI)	Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese
Znj. Entela HAMITI	Anëtare e Partisë Socialiste
Znj. Erinda SHAH	Anëtare e Partisë G99
Z. Ermal GJINAJ	Kreu i departamentit të marrëdhënieve publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë
Z. Eugen Pepa	Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z. Genc HOXHA	Supervizor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania
Z. Gentian ISLAMI	Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia Kuçovë
Z. Gentian MANO	Menaxher i organizatës "World Vision", Librazhd
Znj. Gerta META	Drejtoresh Ekzekutive e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)
Z. Hysni AHMETAJ	Specialist në Ministrinë e Integritetit
Z. Ilir TOPI	Aktivisti i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj. Ingrid PRIZRENI	Shtëpia Botuese "Media Print"
Znj. Liliana ALIMETA	Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave
Znj. Mimoza KOCIU	Këshilltare për median, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës
Z. Plarent RUKA	Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Znj. Plejda GUGASHI	Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania
Z. Redi BADUNI	Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane
Z. Redi SKENDERAJ	Gazetar, Koha TV
Znj. Rezarta GODO	Programi "Brain Gain", PNUD
Znj. Sonila MECO	Gazetare, Klan TV
Z. Urim BAJRAMI	Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z. Afrim Kola	Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare
Z. Alban Fishka	Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror
Znj. Aleksandra Bogdani	Kryeredaktore në "Top News" TV
Znj. Anila Shqypi	Koordinatorë projekti, GTZ Albania
Z. Arber Kadia	Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë

Z. Besjan Peshja	Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI
Z. Bilbil Keraj	Shef i kabinetit në Bashkinë Kukës
Znj. Blerta Gjermeni	Kryeredaktore, ORA News TV
Z. Dritan Nushi	Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë
Znj. Eglantina Bisha	Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"
Z. Elton Lula	Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë
Znj. Enina Mullaj	Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z. Enkes Shundi	Këshilltar, Shef i Protokolit të Presidentit të Republikës
Z. Evarist Beqiri	Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror
Znj. Fatjona Mejdi	Gazetare, "Shqip"
Z. Fjorel Como	Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës
Z. Genard Kastrati	Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve
Znj. Giomela Gjini	Drejtor Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z. Ilir Paco	Gazetar "Top Channel"
Znj. Irena Kita (Dimushi)	Specialiste ligjore në Bankën Credins
Znj. Jonida Shehu	Gazetare në "Vizion Plus" TV
Znj. Karolina Risto	Kryeredaktore e Vizion Plus TV
Znj. Klodiana Thartori	Koordinatorë Programi "Save the Children"
Z. Klodjan Seferaj	Këshilltar në Këshillin e Ministrave
Znj. Klotilda Neziri	Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit
Z. Ledio Milkani	Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë
Znj. Migena Muhaj	Koordinatorë në programin Swiss Partnerships in Health
Znj. Migena Nelaj	Drejtoresh për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH
Z. Ols Lafa	Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Znj. Oriana Arapi	Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritimit në Këshillin e Ministrave
Z. Qemal Cejku	Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës
Znj. Rozana Celmeta	Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z. Saimir Shatku	Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës
Znj. Suela Cela	Specialiste në departamentin ligjor në Ministrinë e Bujqësisë

VITI 2011

Znj. Ada Ramaj	Ndihmëse e zv.ministrit të Brendshëm
Znj. Albana Veizi	Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës
Z. Alvi Bajramaj	Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT
Znj. Anxhela Andoni	Aktiviste e Forumit të Gruas të Partinë Socialiste, rrethi Pogradec
Z. Arlind Lugji	Specialist në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive
Z. Arnold Hajro	Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)
Znj. Daniela Mehmeti	Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës
Znj. Enila Hasani	Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme
Z. Enio Haxhimihali	Shef kabineti në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit
Znj. Erjola Muka	Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë
Z. Genti Çani	Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Z. Gentian Xhaxhiu	Gazetar "Shijak TV"
Znj. Gresa MARTIRI	Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë
Z. Helidon BELE	Drejtor në Tirana Bank
Z. Ilir Stojku	Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë
Znj. Klesta Hysi	Koordinatorë programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"

Z.	Kreshnik Ter-nova	Administrator, ALK Pharma sh.p.k.
Znj.	Ledi Jahja-Muçaj	Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri
Znj.	Merita Man-saku-Meksi	Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim
Znj.	Mirjam Reçi	Drejtoreshë ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës
Znj.	Olta Blaceri	Kryeredaktore e programit "Ora e debatit" në "Ora News" TV
Z.	Qamil Dika	Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist i PD
Znj.	Rajmonda Lajthia	Gazetare, "Vizion Plus" TV

VITI 2012

Znj.	Albana Shtylla	Shefe kabineti në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të zgjedhjeve
Znj.	Alisa Demollari	Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë
Z.	Altin Hoti	Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian
Z.	Altin Ibro	Jurist/ Celibashi Consulting shpk
Z.	Andi Seferi	Drejtues i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri
Znj.	Anisa Seferaj	Juriste/ Bashkia Tiranë
Znj.	Ardita Kongjonaj	Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit
Z.	Arian Galdini	Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi
Znj.	Baisa Sefa	Kërkuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri
Z.	Elidon Laze	Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Erlis Shahu	Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Z.	Ermal Simaku	Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste
Z.	Ermir Godaj	Shërbimi i Përmbartimit, Ministria e Drejtësisë
Znj.	Ervina Domi	Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave
Znj.	Eva Dauti	Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive

Znj.	Florensa Haxhi	Koordinator e strategjive në Këshillin e Ministrave
Z.	Fredi Guga	Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/ Koordinator projekti në "Europartners Development"
Z.	Ilir Kondi	Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)
Z.	Ilir Korbi	Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Ilir Mimani	Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Znj.	Jorina Gjinar	Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future
Z.	Ledio Braho	Jurist në Ministrinë e Integritetit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës
Znj.	Margarita Kola	Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktiviste e partisë politike Aleanca KuqeZi (AK)
Znj.	Mariola Qesaraku	Koordinator e projektit pranë Instituti për Demokraci dhe Meditim
Znj.	Marsida Çela	Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/ Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA
Znj.	Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj.	Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënieve me Publikun në Postën Shqiptare
Z.	Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Z.	Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE
Znj.	Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj.	Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z.	Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj.	Suela Lala	Aktiviste në Shoqërinë Civile

VITI 2013

Znj.	Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
Znj.	Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktiviste në Partinë Demokratike (PD)

Z.	Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
Z.	Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
Z.	Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
Znj.	Blerina Doracaj	Juriste në Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktiviste në Partinë Socialiste (PS)
Znj.	Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktiviste e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj.	Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect
Znj.	Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktiviste në partinë politike Aleanca KuqeZi (AK)
Znj.	Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktiviste e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
Z.	Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
Znj.	Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integritetit/ Aktiviste në Partinë Socialiste
Z.	Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
Znj.	Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
Z.	Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
Z.	Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Z.	Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës
Znj.	Klementina Cenckollari	Gazetare, "Ora News" TV
Z.	Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave
Znj.	Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
Znj.	Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktiviste e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
Znj.	Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BCC Tirana

* I referohet periudhës së pjesëmarrjes në program

ASP

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE PUBLIKIME



Raporti i grupit të personave të shquar të Këshillit të Evropës (2012)

Në verën e vitit 2010, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, kërkoi që një "Grup Personash të Shquar" të pavarur të hartonte një raport mbi sfidat që lindin si rrjedhojë e rigjallërimit të mungesës së tolerancës dhe diskriminimit në Evropë. Falë kontributit të shkollës, ky botim vjen në gjuhën shqipe.



Mirëqeverisja - Përmbledhja e eseve të shkollës (2012)

Me përfundimin e ciklit të programit të shkollës, pjesëmarrësit duhet të prezantojnë një ese përfundimtare. Në vitin 2012 u përzgjedhën nëntë ese më të mira, të cilat vijnë si një botim i vecantë në gjuhën shqipe.



Raporti vjetor i aktivitetit të ASP (2012)

Një përmbledhje e aktiviteteve të një viti të suksesshëm të Akademisë së Studimeve Politike. Duke analizuar të gjithë rrugëtimin njëvjeçar, ndjehemi krenarë për rezultatet, por në të njëjtën kohë dimë se ka ende rrugë për të bërë. Botimi vjen në gjuhën shqipe dhe atë angleze.



Manuali për zgjedhësit e rinj (2013)

Ky manual është përgatitur për të informuar të rinjtë dhe këdo tjetër mbi sistemin zgjedhor, të drejtat dhe detyrimet e votuesit, por gjithashtu mund të shërbejë si një burim i mëtejshëm i edukimit qytetar mbi demokracinë, sistemet politike, organizimin e shtetit dhe funksionimin e institucioneve të vendit.



Energji efçente, energji e sigurtë (2013)

Botimi është përgatitur falë bashkëpunimit të ekspertizës profesionale dhe eksperiencës më të mirë të ASP në përgatitjen e materialeve ndërgjegjëse. Broshura në gjuhën shqipe, përmban informacione bazë mbi eficientë e energjisë dhe masat e kursimit që mund të ndërmarrë çdo qytetar.



Buletini i shkollave politike të Këshillit të Evropës

Buletini i veprimtarive të Shkollave të Studimeve Politike të Këshillit të Evropës është një botim periodik tremujor në gjuhën angleze rreth aktivitetit të shkollave. Për të siguruar numrat e buletinëve, mund të abonoheni falas online në: www.schoolsofpoliticalstudies.eu/newsletter.asp

Akademia e Studimeve Politike

Kotoni Center, Tel/fax: +355 4 2272173
Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, +355 4 4504788
Kati 4, Zyra 2 E-mail: info@asp.al
Tirane, Shqipëri Web: www.asp.al

Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
 Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
 Akademia Studimeve Politike
 Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike
financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra
e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si
edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

State Secretariat for
Economic Affairs SECO

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë
www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha
këto botime në versionin pdf.
Skanoni këtë kod për më tej QR CODE

